



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ prot

Vlorë, _____ . _____ . 2019

RAPORT

Për transparencën në procesin e vendimarrjes nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2019

Të nderuar këshilltarë !

Këshilli i Bashkisë Vlorë, gjatë vitit 2019 është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin vëmendjen e duhur për një shërbim të kulturuar dhe cilësor ndaj komunitetit e të qytetarëve të Vlorës . Mbi bazën e kalendarit vjetor janë trajtuar vendime të rëndësishme që kishin impakt të fuqishëm në lidhje me përmirësimin e cilësisë së jetës të banorëve tanë si në strukturat komunitare në qytet ,ashtu edhe për ato të fshatit.Prioritare kanë qenë vendimet që i kushtoheshin problemeve për familjet me probleme të thella sociale,eliminimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore , dhënie ndihme financiare jo vetëm nga fondi i kushtëzuar por edhe nga ndihmat mujore me të ardhurat e bashkisë. Kemi akorduar bonus strehimi për familjet që nuk përballonin dot pagesat e qerasë në tregun e lire, janë marrë vendime për disiplinimin e transportit rrugor urban,për miratimin e manualit të arredimit urban të qendrës historike të qytetit të Vlorës,për miratimin e privatizimit të banesave shtetërore të paprivatizuara,për përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit për ujin e pishëm,për pajisjen e dhjetëra subjekteve në fshat me AMTP,për një mjedis të kulturuar,për gjelbërimin dhe asfaltimin e lagjeve në qytet etj.

Për periudhën janar –dhjetor 2019 gjithsej janë marrë 133 vendime në Këshillin e BashkisëVlorë.

Vlen për tu theksuar se të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak kanë qenë konform ligjeve dhe vendimeve të Qeverisë. Për vendimet e marra nga ky këshill për vitin 2019 institucioni i Prefektit të Qarkut është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre.

I vetmi projekt-vendim i kthyer është ai i kryetarit të bashkisë, i cili mori spuntin nga vërejtje e sugjerime që u bënë në mbledhje me qëllim për ta përmirësuar më tej projektin e paraqitur nga vet administrata e bashkisë për familjet dhe individët që përfitojnë nga zbatimi i programit të banesave me kosto të ulët nëpërmjet kredive me kushte lehtësuese nga buxheti i Bashkisë. Pra vendimi nr 16 u kthye për rishqyrtim nga Kryetari i Bashkisë dhe jo nga institucioni i Prefektit të Qarkut. Administrata dhe këshilli duke reflektuar mbi kërkesat e Kryetarit të Bashkisë morën vendimin nr 39 dt, 28.03.2019, për të cilin është shprehur i ligjshëm dhe institucioni i Prefektit të Qarkut.

Nga sa thamë më lart, këto vendimmarrje të këshillit, flasin qartë për shqetësimin dhe bashkëpunimin e administratës dhe Këshillit të bashkisë për t'u përgjigjur në kohë dhe sipas legjislacionit në fuqi gjithë shqetësimeve dhe problematikave të komunitetit të Vlorës.

Nga karakteri i vendimeve mund ti ndajmë në të miratuara për probleme financiare 16 vendime, për probleme sociale, 32 vendime, për infrastrukturën dhe strehimin 12 vendime, për problemet urbane dhe asetet 5 vendime, për emergjencat civile 14 vendime, për probleme të arsimit kulturës, AMTP-ve, projekteve kulturore etj 54 vendime. Kjo flet qartë për një gamë të gjerë problematikash për të cilat Këshilli i Bashkisë ka bërë 10 dëgjesa publike në njësitë administrative të Vlorës dhe strukturave komunitare në fshat. Nga këto dëgjesa të cilat janë njoftuar më parë nëpërmjet fletëpalosjeve, njoftimeve në internet dhe rrjeteve sociale si dhe afisheve të vendosura nëpër njësitë administrative dhe lagjet e qytetit, janë bërë propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme, kryesisht për buxhetin dhe paketën fiskale.

Bashkia dhe sidomos Këshilli Bashkiak, kanë vlerësuar kërkesat e tyre dhe kanë këmbëngulur që ato të gjejnë pasqyrim në vendimmarrjet e tij, **për shembull, në njësinë e Orikumit**, janë marrë parasysh rikonstruksioni i kullës së Dervish Aliut, plotësimi i ndricimit rrugor në Orikum, në Tragjas, Dukat e Rradhimë, si dhe shtesa e kërkuar për skuadrën e futbollit të Orikumit.

Buxhetimi me pjesëmarrje i cili merre parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve ishte kyçi i suksesit për të gjitha njësitë administrative.

Në njësinë administrative të Novoselës, kërkesat ishin kryesisht për ndricimin në të gjithë fshatrat, për rikonstruksionin e rrugës Cerkovinë-Trevllazër, të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë vendosur në buxhetin e vitit pasardhës.

Në njësinë qendër vërejtjet dhe sugjerimet ishin për rikonstruksionin shkollës Babicë, dhe rrugës së Xhyherinës dhe përmirësimin e infrastrukturës në fshatrat

turistike si Kanina dhe Zvërneci të cilat u vlerësuan dhe u morën parasysh në buxhetin e Bashkisë Vlorë.

Në njësinë Llakatund, sygjerimet dhe ankesat e qytetarëve ishin që bashkia dhe Këshilli të fusnin në buxhet rikonstrukcionin e rrugës së Drithasit, rikonstrukcionin e banesave të qytetarëve rom në këtë njësi, zëvendësimin i ndriçuesve të cilat u morën parasysh nga këshilli.

Në qytet u bënë sygjerime për rritjen e fondit për sportin e kikbox, për riasfaltimin e rrugëve dhe të lagjeve problematike për çdo rajon, për ndricim dhe gjelbërim, për sistemimin e parkingjeve publike në Lungomare, për rikonstrukcionin e shkollës Lef Sallata dhe 24 Maji, për rikonstrukcioni e muzeut Etnografik, për rrugën e varrezave të qytetit, për përmirësimin e kushteve të cerdheve dhe kopshteve, shtimin e aktiviteteve për festat lokale nëpër lagje dhe njësi administrative të cilave u është lënë i hapur aplikimi dhe zbatimi nga ana e administratës dhe këshillit të Bashkisë.

Për sa më lartë, bashkia dhe këshilli i kanë vlerësuar të gjitha këto kërkesa si të drejta, të cilat kanë rritur cilësinë e jetesës dhe kanë ndikuar në dhënin e një profili të qartë turistik dhe tërheqës, jo vetëm për qytetet e tjera por edhe për turistët e huaj.

Nuk janë marrë parasysh sygjerimet që bënin fjalë për ndërtimin e rrugëve dhe ujësjellsave në çdo fshat, ashtu sikundër për ndricimin në disa lagje dhe fshatra të caktuara, që nuk janë zbatuar. Të gjitha këto, kanë ardhur si pasojë e buxhetit të pamjaftueshëm të Bashkisë, por do të merren në konsideratë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Për dëgjesat publike, ka ende shumë për të bërë pasi në bazë të ligjit 146 të vitit 2014, për njoftimin dhe konsultimin publik, kufizimet për to janë vetëm për çështjet e sigurisë kombëtare, për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe midis bashkive dhe shteteve të ndryshme, për aktet administrative individuale, për aktet normative me fuqinë e ligjit dhe problemet emergjente. Pra. Këshillit të Bashkisë i del detyra për të shtuar numrin e dëgjesave publike sipas kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe mundësisht për çdo projekt akt të bëjë njoftimin publik jo vetëm nëpërmjet postës elektronike por edhe nëpërmjet postave dhe njoftimeve mbi bazë lagjesh dhe fshatrash për të nisur dhe projektuar ato akte që kanë përparësi për qytetarët.

Del si detyrë që çdo këshilltar për aktet normative të cilat do të diskutohet dhe vendoset në këshill të bëjë dëgjesa publike me lagjen ose fshatin, të marrë opinionet dhe vërejtjet e tyre para se të gjykohet për të.

Për rrjedhojë është e domosdoshme që këshilli të përdorë më mirë rrjetet sociale për njoftimin e qytetarëve, të krijojë rubrika me pyetësorë dhe marrje komentesh prej tyre, duke mësuar se cilat janë prioritetet e tyre mbi bazë njësie, rajoni dhe fshattrash.

Një shqetësim për Këshillin e Bashkisë ka qenë organizimi i dëgjesave me një afat të shkurtër duke mos respektuar afatet ligjore për përgatitjen e tyre :jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projekt aktit që do të diskutohet. Megjithëse Këshilli është vlerësuar nga këshillat më të mirë jo vetëm të qarkut tonë por edhe më gjerë, jemi të mendimit që ti kushtohet më tepër kujdes mbajtjes së procesverbaleve dhe arkivimit të tyre.

Një shqetësim në këtë drejtim është edhe ruajtja e arkivës digjitale. Mbi bazen e projektit Bashki te Forta dhe pervojës ne Lozan te Zvicres, Keshilli i Bashkise ka përgatitur librin e protokollit si dhe do te ngreje arkiven digjitale me fokus ruajtjen e memories vizive dhe dokumentare per te krijuar lehtesi per anetaret e Keshillit te Bashkise per njohjen dhe shfrytëzimin e tyre.

Mendojme që për këtë vit, Keshilli i Bashkise, me reformen për përgatitjen dhe miratimin e disa rregulloreve, siç është ajo për organizimin dhe funksionimin e Keshillit të bashkise, për organizimin dhe funksionimin e strukturave komunitare në fshat apo për kodin e etikës, për marrëdhëniet e komunikimit publik dhe medias, etj duhet të shfrytëzojë sa më mirë dëgjesat publike . Fillimisht tu bëjmë të njohur banorëve në qytet apo fshat se cili do të jetë akti që do të diskutohet,tu vihet ai në dispozicion nëpërmjet faqes së bashkisë,të njihen dhe dërgohen e-mail shumë aktorëve që ju keni njohje etj duke përcaktuar datën ,orën dhe vendin e takimit.

Për sa më sipër vlerësojmë përvojën pozitive dhe ndërkohë kërkojmë plane tuaja për dëgjesat në zonat ku banoni apo jeni caktuar për të kryer detyrën e këshilltarit. Faleminderit!